



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ Nr/ 74 /2011

Në bazë të nenit 17, Kompetencat Vetanake nënparagrafi (f) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, , neni 6 nënparagrafi (f) i Statutit të Komunës, mbështetur në rregulloren e Kuvendit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2011 merr këtë:

V E N D I M
P Ë R
T H E M E L I M I N E N D Ë R M A R R J E S P U B L I K E K O M U N A L E

I

Merret vendimi për miratimin e propozim vendimit me numër 01/Nr.74/2011 të datës 20.06.2011 për themelimin e ndërmarrjes Publike Komunale.

II

Duke iu referuar nenit I të këtij vendimi Ndërmarrja Publike Komunale nëpërmes këtyre veprimtarive do të bëjë mirëmbajtje efektive si për ujësjellës , kanalizimit, menaxhimin të mbeturinave, mirëmbajtjen e parqeve publike, shesheve, varrezave të dëshmorëve, menaxhimin e tregut dhe mirëmbajtjen e tij.

III

Ky vendim është shumë i nevojshëm për Komunën e Hanit të Elezit, duke pasur parasysh se menaxhimi i shërbimeve primare publike nuk ka qenë të rregulluara, mirëpo në bazë të kësaj kompanie do të krijohen kushte më të mira në favor të qytetarëve dhe Komunës në përgjithësi.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit.

V

Me këtë vendim njoftohen: Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:30.06.2011

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Menduh Vlasi

